



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kryetarja e Komunës**

**01nr**

**Dt: 26.01.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58. b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 dhe Përfundimit nr.06-6705-1/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt: 23.01.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për formimin e komisionit për vlerësimin e gjendjes së objekteve të banimit në rr. “B.Curri”, të cilat rrezikohen nga rrënimi për shkak të shembjes së dheut në bregun e lumit “Krena”, me dt: 26.01.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Formohet Komisioni për vlerësimin e gjendjes së shtëpive të banimit të qytetarëve të cilët banojnë afër segmentit të bregut të lumit “Krena” në rr. “B.Curri” në Gjakovë , në këtë përbërje:

1. Riza Morina, kryesues
2. Lulzim Haxhiu, anëtar
3. Negjib Qehaja , anëtar

**II.** Komisioni i përshkruar në pikën paraprake duhet të angazhohet për verifikimin e gjendjes momentale të objekteve të banimit të qytetarëve në rr. “B.Curri” në Gjakovë, të cilat janë të rrezikuara nga rrënimi për shkak të degradimit dhe shembjes së bregut të lumit “Krena” dhe njëherësh duhet të harton një raport zyrtar, me të cilin do të konstatohet gjendja faktike në terren dhe me këtë dokument të njoftohet Kryetarja e Komunës, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**IV.** Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës,**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**